



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 87/ prot.

8

Tiranë, më 07.03.2025

VENDIM

Nr. 1163 , Datë 07.03 . 2025

“PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1152, DATË 23.01.2025 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE TË GRUPIT ASIA PULP & PAPER NGA Z. JACKSON WIJAYA LIMANTARA”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.03. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi një korrigjim të një gabimi material në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 1152, datë 23.01.2025 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neni 112 i ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pasi shqyrtoi relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një korrigjim të një gabimi material në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 1152, datë 23.01.2025 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara”,

VËREN SE :

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 87/6 prot., i AK datë 11.02.2025 “Kërkesë për redaktim dhe korrigjim Vendimi AK nr. 1152, datë 23.01.2025”, është njoftuar në lidhje me një gabim

material të shprehur në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 1152, datë 23.01.25. Referuar tekstit të Vendimit, pala njoftuese ka konstatuar se emri i palës dhuruese është shkruar gabim.

Në Kontratën e Dhurimit (varianti shqip), emri i palës dhuruese është përkthyer gabim nga **Oei Tjie Goan** në **Oei Tijie Goan**.

Për sa më sipër, pala njoftuese ka kërkuar korrigjimin e këtij gabimi në shkrim.

Në nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*

2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Komisioni i Konkurrencës gjykon se ky gabim material nuk cenon thelbin e aktit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 112 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,


VENDOSI:

1. Në faqen nr. 2 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 1152, datë 23.01.2025 “Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara”, emri Oei Tijie Goan të korrigjohet dhe të zëvendësohet me emrin Oei Tjie Goan.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana KONOMI

()

Anëtar

Durim KRAJA

()

Anëtar

Fatjola DELIJA

()

Anëtar

Denar BIBA

()

Kryetar

